



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Nr. 2338/2 Prot

Tiranë, më 24.09 /2020

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.215 prot, datë 17.09.2020 “Njoftim për vende të lira pune” të Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, protokolluar pranë AKPA-s me nr.2338 prot, datë 21.09.2020, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në portalin e AKPA-së, brenda datës 25.09.2020, si më poshtë:

Pozicionet e punës:

- a) 1 mësimdhënës i teorisë profesionale në drejtimin Shërbime Mjete Transporti
- b) 1 mësimdhënës i teorisë profesionale në drejtimin Elektroteknike e Integruar me Elektronikën

1. Kriteria të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteria të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës,

- a) të ketë diplomë nga një institucion i arsimit të lartët të nivelit master i profesionit ose master i shkencave ose të barasvlershme, për një nga profilet që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;

- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacioni.

3. Dokumentet e aplikimit

- a) letër motivimi për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit *Europass* në shtojcën 1, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,
- c) të dhënat e aplikuesit, të plotësuara sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 2, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,
- d) fotokopje të kartës së identitetit, fotokopje të diplomës dhe fotokopje të librezës së punës;
- e) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- f) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- g) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- h) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- i) vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- j) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, brenda datës 06.10.2020.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Elira DEMIRAJ

